



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	
Njësia org. Org. Unit	17-01
Nr. i Faqeve Pc. Stranica No. Pages	02
Nr. i Prot. Broj Prot. Prot. No.	1988-2/17
Data: Datum: Date:	23.08.24
PRISHTINË / A	
No. 1	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Kabineti i Ministrit / Kabinet Ministra / Kabinet of the Minister

Nr. 305
Data: 09/08/2024

Ministri i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës duke u bazuar në nenin 93 paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 10 dhe nenin 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare, Nr.7/2019 dt. 01 mars 2019), nenin 11 paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare, Nr.34/22 dt. 18.11.2022), Shtojcën 1 pika 10 të Rregullores (QRK) - Nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenin 10 paragrafi 2 të Ligjit Nr.08/L-071 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-060 për Mbeturina (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 29/01 Shtator 2022), si dhe nenit 53 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 20/21 Qershor 2016), Udhëzimit Administrativ MMPHI 02/2024 për Përcaktimin e Kushteve, Kriteve dhe Procedurave për Lëshimin e Lejes për Eksport, Import dhe Kalimin Tranzit të Mbeturinave, nxjerr:

V E N D I M

1. Shfuqizohet Vendimi me Nr. 22 dhe Nr. Prot.: 1988/17 i datës 14.04.2017 i Ministrit të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për Regjistrin dhe Regjistrimin e Zotëruesit të Mbeturinave - Tregtarit dhe Ndërmjetësit për Mbeturina jo të rrezikshme.
2. Shfuqizimi i Vendimit për Regjistrin dhe Regjistrimin e Zotëruesit të Mbeturinave - Tregtarit dhe Ndërmjetësit për Mbeturina jo të rrezikshme bëhet në zbatim të nenit 10 paragrafi 2 të Ligjit Nr.08/L-071 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-060 për Mbeturina dhe dispozitave ligjore të Udhëzimit Administrativ MMPHI 02/2024 për Përcaktimin e Kushteve, Kriteve dhe Procedurave për Lëshimin e Lejes për Eksport, Import dhe Kalimin Tranzit të Mbeturinave.
3. Zotëruesi i mbeturinave nuk mund të bartë te personi tjetër kompetencat për menaxhimin e mbeturinave, nëse nuk është person i pajisur me leje përkatëse mjedisore.
4. Bazuar në nenin 10 paragrafi 1 të Ligjit Nr.08/L-071 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-060 për Mbeturina, mbledhjen, grumbullimin, transportimin, trajtimin, përpunimin, magazinimin, riciklimin dhe deponimin e mbeturinave e bëjnë operatorët e pajisur me leje përkatëse mjedisore. Po ashtu nenet 3,15,16 dhe jo vetëm të Udhëzimit Administrativ MMPHI 02/2024 për Përcaktimin e Kushteve, Kriteve dhe Procedurave për Lëshimin e Lejes për

Eksport, Import dhe Kalimin Tranzit të Mbeturinave, përcaktojnë procedurën e pajisjes me leje për eksport, import dhe kalim tranzit të mbeturinave.

5. Certifikatat e operatorëve të marra para hyrjes në fuqi të këtij Vendimi vlejnë deri në skadimin e afatit të tyre të përcaktuar në certifikatën përkatëse. Pas përfundimit të këtij afati, operatorët mund të ushtrojnë veprimtarin e tyre sipas rregullave të përcaktuara në Ligjin Nr. 04/L-060 për Mbeturina, Ligjin Nr.08/L-071 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-060 për Mbeturina dhe Udhëzimin Administrativ MMPHI 02/2024 për Përcaktimin e Kushteve, Kriteve dhe Procedurave për Lëshimin e Lejes për Eksport, Import dhe Kalimin Tranzit të Mbeturinave.

6. Vendimi hyn në fuqi shtatë (7) ditë, pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Liburn ALIU

Ministër i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe
Infrastrukturës

Vendimi i dërgohet:

- Kabinetit të Ministrit;
- Sekretarit të Përgjithshëm;
- Arkivit të MMPHI-së .